

UDHËZIM
Nr.646, datë 20.3.2006

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.74, DATË 11.2.1999
“PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET MBËSHTETJES SË
FORMIMIT INSTITUCIONAL”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.74, datë 11.2.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet mbështetjes së formimit institucional” dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 17.1.1998 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, i ndryshuar, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

UDHËZON:

1. Ka të drejtë të aplikojë në programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet mbështetjes së formimit institucional, çdo subjekt i cili është person juridik/fizik me veprimtari të licencuar nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale.

2. Subjektet që aplikojnë duhet të plotësojnë këto kushte:

i) nuk duhet të kenë bërë pushime nga puna (pa shkaqe të arsyeshme) në një periudhë njëvjeçare përpara aplikimit për programin e nxitjes së punësimit;

ii) të kenë derdhur rregullisht sigurimet e detyrueshme për një periudhë të paktën njëvjeçare;

iii) të mos kenë pasur shkelje të legjislacionit të punës të verifikuara nga inspektorati i punës për një periudhë njëvjeçare.

3. Për të përfituar nga ky program, punëdhënësi duhet të paraqesë pranë zyrës përkatëse të punësimit të rrethit ku ai zhvillon aktivitetin, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Një informacion mbi:

i) përshkrimin e detajuar të aktivitetit që kryen,

ii) kapacitetin e qendrës,

iii) studim mbi dobinë social-ekonomike që sjell zhvillimi i kursit.

b) Numrin e llogarisë bankare;

c) Një informacion mbi:

i) numrin e punëkërkuesve që kërkohen të trajnohen,

ii) profesionin për të cilin do të trajnohen,

iii) kohëzgjatjen e trajnimit,

iv) llojin e kontratës që kërkon të zbatohet,

v) nivelin e pagesës që ai ka dhënë për çdo person,

vi) fushën e trajnimit.

ç) Vërtetim nga dega e tatim-taksave e rrethit ku ushtron veprimtarinë personi juridik/fizik, për shlyerjen e detyrimeve tatimore, për periudhën njëvjeçare pararendëse dhe periudhën në vazhdim deri në momentin që aplikon për program nxitje punësimi;

d) Vërtetim nga dega e tatim-taksave e rrethit ku ushtron veprimtarinë personi juridik/fizik, për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, dhe numrin e personave të siguruar për tre muajt e fundit.

e) Lista e punëkërkuesve të punësuar dhe të siguruar para aplikimit për përfitim për programe nxitje punësimi.

Me të dhënat e dokumentacionit të mësipërm, subjekti në bashkëpunim me zyrën përkatëse të punësimit, plotëson formularin përkatës.

4. Inspektori i Inspektoratit Rajonal dhe Vendor të Punës, bën verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti sipas germave a, c dhe e dhe shprehet brenda 7 ditëve mbi vërtetësinë e këtij dokumentacioni, si dhe korrektësinë e subjektit ndaj legjislacionit të punës. Marrëdhëniet midis tyre rregullohen me urdhrin nr.418, datë 25.2.2004 të Ministrisë të Punës dhe Çështjeve Sociale.

5. Zyra kompetente e punësimit shpall në media çdo fillim viti numrin e projekteve që do të financojë sipas prioritetëve të vendosura nga Ministri.

6. Në rastet kur për një projekt ka të paktën tre aplikues zyra kompetente e punësimit ia paraqet ato Këshillit Lokal Tripalësh, i cili shqyrton dhe vendos mbi dobishmërinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen.

7. Pas miratimit në parim të projekteve në Këshillin Lokal Tripalësh, zyra kompetente e punësimit i rendit aplikimet sipas prioriteteve të vendosura nga Ministri dhe i dërgon për miratim në komisionin e miratimit të projekteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

8. Mënyra e vlerësimit të projekteve nga komisionet përcaktohet në një rregullore të miratuar nga Këshilli Administrativ Tripalësh i SHKP-së.

9. Në Drejtorinë e Përgjithshme të SHKP-së, ngrihet komisioni i miratimit të projekteve.

Mënyra e funksionimit e metodikës së punës dhe përbërjes së komisionit përcaktohet me rregullore të veçantë të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

10. Komisioni i miratimit të projekteve i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, vendos për miratimin ose jo të një projekti brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së dokumentacionit të plotësuar, nga subjekti.

11. Për projektet e miratuara, zyra kompetente e punësimit në bashkëpunim me subjektin plotësojnë listën e punëkërkuesve të papunë që do të përfshihen në program. Punëkërkuesit e papunë që përfshihen në program duhet të jenë të regjistruar në zyrat e punësimit për një periudhë të paktën tremujore.

Ndërmjet zyrave kompetente të punësimit dhe subjekteve nënshkruhet një kontratë ku përfshihen të drejtat dhe detyrat që përcakton programi për secilën palë. Kontratat e lidhura ndërmjet subjekteve dhe zyrave kompetente të punësimit janë të vlefshme vetëm për vitin kalendarik.

Në rastet kur financimi vazhdon për vitin pasardhës, shtesa përkatëse në kontratë bëhet pasi kryhet një vlerësim për zbatimin e projektit me kontratën e parë.

12. Subjekti deklaron garantimin e punësimit për 20% të pjesëmarrësve në trajnim.

Në rastet e mospunësimit të kuotës së përcaktuar më sipër, ndaj subjektit aplikohen sanksionet e mëposhtme:

a) Subjekti nuk ka të drejtë të riaplikojë për projekte të programeve të nxitjes së punësimit;

b) Subjekti kthen shumën e financimit të marrë për 20% të pjesëmarrësve të trajnuar.

13. Në zbatim të pikës 1, paragrafit të parë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.74, datë 11.2.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet mbështetjes së formimit institucional”, zyra kompetente e punësimit paguan tarifat e trajnimit institucional të kursantëve punëkërkues të papunë të regjistruar nga zyra e punësimit, për një periudhë 6-mujore, me përjashtim të programeve që zbatohen në fushën e industrisë minerale, nxjerrëse dhe përpunuese ku kohëzgjatja mund të jetë deri në 9 muaj. Përcaktimi i masës së tarifës bëhet me marrëveshje midis subjektit dhe zyrës kompetente të punësimit dhe miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme e SHKP-së.

14. Financimi ndaj subjektit bëhet duke iu referuar nivelit të pagës minimale në shkallë vendi, për efekt të zbatimit të këtij vendimi.

15. Në zbatim të paragrafit të dytë të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.74, datë 11.2.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet mbështetjes së formimit institucional”, në rastin kur subjekti punëson me kontratë të rregullt njëvjeçare (sipas profesionit për të cilin u trajnuan) mbi kuotën 20% sipas pikës 1 të paragrafit të parë të vendimit të Këshillit të Ministrave të sipërpërmendur, subjekti përfiton një shpërblim shtesë deri në tri paga minimale në shkallë vendi për çdo të punësuar mbi këtë kuotë.

16. Në zbatim të pikës së dytë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.74, datë 11.2.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet mbështetjes së formimit institucional”, Shërbimi Kombëtar i Punësimit financon jo më shumë se 60% të kostos së përgjithshme të kursit, kur 60% e kursantëve janë punëkërkues të papunë nga lista e zyrës së punësimit.

Në zbatim të pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave të sipërpërmendur, punëkërkuesit e papunë që marrin pjesë në projektin e formimit profesional, përfitojnë pagesë pjesëmarrje në kurs në masën 50% të pagës minimale në shkallë vendi. Për punëkërkuesit e papunë përfitues të programeve shtetërore të mbështetjes me të ardhura (pagesë papunësie dhe ndihmë ekonomike) pagesa është 80% e pagës minimale në shkallë vendi.

17. Zyra kompetente e punësimit çregjistron nga lista e punëkërkuesve të papunë personat që pa arsye të pranueshme refuzojnë të marrin pjesë në program. Procedurat përcaktohen në rregulloren e

Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

18. Zyra kompetente e punësimit plotëson listën e personave të përfshirë në program, të cilët janë përfitues të pagesës së papunësisë. Zyra kompetente e punësimit llogarit, nëpërmjet kësaj liste, fondet e kursyera nga ai program të cilat i kalojnë masën 100% buxhetit të këtij programi.

19. Zyra kompetente e punësimit plotëson listën e personave të punësuar që janë pjesëtarë të familjeve përfituese të programit të ndihmës ekonomike. Zyra e punësimit llogarit nëpërmjet këtij formulari sasinë e fondeve që përfiton ky program nga punësimi i tyre. Kjo sasi është 50% e ndihmës ekonomike të plotë për një familje me 4 persona për çdo muaj trajnim.

20. Marrëdhëniet midis zyrave kompetente të punësimit, subjektit dhe punëkërkesve të papunë të punësuar sipas këtij programi, vendosen në marrëveshje të përbashkëta midis tyre. Subjekti dhe punëmarrësi nënshkruajnë një kontratë për kushtet e punësimit të personave që punësohen. Kontrata përmban në çdo rast emrat e të gjithë personave që do të angazhohen në program.

21. Në rastet ku punëmarrësit pjesëmarrës në programe trajnimi sipas këtij programi largohen përpara afatit të përcaktuar në kontratë, subjekti duhet të bëjë njoftim në zyrën e punësimit. Kursantët e larguar nuk zëvendësohen. Zyra kompetente e punësimit bën menjëherë ndërprerjen e financimit për kursantin e larguar.

22. Zyra kompetente e punësimit përpilon dhe dërgon çdo muaj në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit informacione në lidhje me projektet, zbatimin e tyre, personat e trajnuar, personat e punësuar, përfituesit e programeve të mbështetjes me të ardhura, punëkërkesit e papunë etj.

23. Procedurat e mëtjeshme për përdorimin e fondeve të nxitjes së punësimit, përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrit të Financave nr.1, datë 5.2.2001 “Për kriteret dhe procedurat e subvencionimit për të nxitur punësimin”.

24. Procedurat për zbatimin e këtij programi, formularët tip, kontratat tip, marrëveshjet tip, përcaktohen me rregulloren metodike të zbatimit të programit të miratuar nga Këshilli Administrativ Tripalësh i Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Kontratat dhe marrëveshjet tip të miratuara, të shërbejnë vetëm si udhëzues për punonjësit e zyrave të punësimit, ndërkohë që ato duhet të rishkruhen për çdo rast lidhje kontrate me subjekte të ndryshme.

25. Për përparësitë dhe fushat prioritare ku do të zbatohet programi, të zbatohet urdhri i nxjerrë çdo fillim viti nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

26. Udhëzimi nr.895, datë 12.4.2000 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.74, datë 11.2.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet mbështetjes së formimit institucional”, ndryshuar me udhëzimin nr.74, datë 14.1.2004” shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOÇO BARKA
MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA